




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunication Regulatory Authority
Regulatorni Autoritet Telekomunikacije



NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORËS PËR TARIFIM TË SPEKTRIT

Duke pasur parasysh menaxhimin sa më efikas të resurseve të kufizuara frekuencore, eliminimin e paqartësive të cilat mund të krijohen gjatë procesit të tarifimit,

duke pasur qëllim inkurajimin dhe krijimin e lehtësive për ofruesit e shërbimeve telekomunikuese dhe palëve tjera të interesuara, si dhe

duke u bazuar në praktikat e mira të shteteve rajonale dhe evropiane, është paraqitur nevoja për ndryshimin e Rregullorës për Tarifim të Spektrit Frekuencor.

Andaj miratohet ky ndryshim,

Neni 1 Ndryshim

Neni 5 pika 5.1 A) ndryshohet si në vijim

5.1. Brezi frekuencor 156-174 MHz

A. Për sistemet duplekse dhe gjysëm-duplekse (kur numri i popullësisë nuk është më i madh se 50 mijë banorë) me gjërësi të brezit 12.5kHz tarifa vjetore do të jetë si në tabelën vijuese:

Zona e mbulimit	Stacion baze – Repetitor (Repetitor - Repetitor)	Stacion baze – Mobil (Repetito – Mobil)
< 15 km	240 €	160 €
≥ 15 dhe < 40 km	300 €	240 €
≥ 40 dhe < 70 km	500 €	420 €
≥ 70 km (Në tërë Kosovën)	650 €	550 €

Neni 7 pika 7.1), 7.2), 7.3), 7.4) ndryshohen si në vijim

7.1. Brezi frekuencor prej 1 deri 10 GHz (≥ 1 GHz dhe <10 GHz)

Në tabelën në vijim janë dhënë tarifat për brezin 1-10 GHz:

Gjersia e kanalit (per cdoTx)	Tarifa vjetore
≤ 0.5 MHz	150 €
>0.5 MHz dhe ≤ 2 MHz	300 €
>2 MHz dhe ≤ 7 MHz	600 €
>7 MHz dhe ≤ 15 MHz	1000 €
>15 MHz dhe ≤ 30 MHz	2000 €
>30 MHz	3000 €

7.2. Brezi frekuencor nga 10 deri 15.35 GHz (≥ 10 GHz dhe <15.35 GHz)

Për këtë brez frekuencor tarifat e propozuara në pikën 7.1 shumëzohen me koeficientin reduktues 0.8

7.3. Brezi frekuencor nga 15.35 deri 22 GHz (≥ 15.35 GHz dhe <22 GHz)

Për këtë brez frekuencor tarifat e propozuara në pikën 7.1 shumëzohen me koeficientin reduktues 0.6

7.4. Brezi frekuencor nga 22 deri 30 GHz (≥ 22 GHz dhe <30 GHz)

Për këtë brez frekuencor tarifat e propozuara në pikën 7.1 shumëzohen me koeficientin reduktues 0.5

7.5. Brezi frekuencor mbi 30 GHz (≥ 30 GHz)

Për këtë brez frekuencor tarifat e propozuara në pikën 7.1 shumëzohen me koeficientin reduktues 0.3.

Neni 2 Dispozitat Kalimtare

Ky ndryshim për të licencuarit ekzistues në këto breze frekuencore do të jetë i zbatueshëm pas përfundimit të afatit për të cilin janë të licencuar.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky ndryshim hyn në fuqi datën e nënshkrimit të tij.

Dt. 13.02.2009



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

Anton Berisha, Kryetar i Bordit